

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues e ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e inspektimit dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime paraprake

Vizita inspektuese e Mekanizmit Kombëtar në IEVP Fushë-Krujë, u zhvillua në kuadër të monitorimit të institucioneve ku privohet liria e personit për vitin 2022, brenda juridiksionit që parashikon legjislacioni për institucionin e Avokatit të Popullit.

Grupi i inspektimit, mbi bazën e metodologjisë për inspektimet në burgje, zhvilloi takim me drejtorin e institucionit z.Qazim Hoxha, shefin e policisë z.Fatjon Sadikaj, si dhe shefat e sektorit juridik, çështjeve shoqërore, logjistikës dhe të burimeve njerëzore, të cilët pas prezantimit, u vunë në dijeni në lidhje me qëllimin e këtij inspektimi.

Më tej, ata informuan mbi gjëndjen e respektimit të të drejtave të të burgosurve dhe kushtet infrastrukturore në këtë institucion, aktivitetet që zhvillohen me qëllim rehabilitimin e tyre, si dhe raportuan në lidhje me realizimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm.

Sipas informacionit, rezultoi se bazuar në Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, **IEVP Fushë-Krujë kategorizohet burg i sigurisë së zakonshme**, me një seksion për të dënuarit siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Kapaciteti i institucionit, referuar hapësirave dhe sipërfaqeve të dhomave të banimit, si dhe numrit të shtretërve është **për akomodimin e 312 të burgosurve**². Pavarësisht këtij informacioni të gjetur në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, nuk na u vu në dispozicion vendimi i shpërndarjes së kapacitetit, pasi mungonte një urdhër i cili miraton kapacitetin e kësaj IEVP-je.

Në kohën e inspektimit në IEVP Fushë-Krujë ishin akomoduar **397 persona të burgosur**, nga të cilët 69 të dënuar dhe 328 të paraburgosur. Sipas gjendjes faktike, institucioni kishte situatë **mbipopullimi me 85 të burgosur** mbi kapacitetin e tij fizik.

Grupi i inspektimit kërkoi gjithashtu dhe një informacion për situatën e popullimit në institucion për periudhën e janar-maj 2022, e cila rezultoi të ishte si më poshtë:

² <https://dpbsh.gov.al/ievp/ievp-fushe-kruje/>

- Janar 2022 - 372 të burgosur/60 persona mbi kapacitet ose 19%
- Shkurt 2022 - 372 të burgosur/60 persona mbi kapacitet ose 19%
- Mars 2022 - 396 të burgosur/84 persona mbi kapacitet ose 27%
- Prill 2022 - 401 të burgosur/89 persona mbi kapacitet ose 28%

Referuar statistikave të popullimit për periudhën janar-maj 2022 rezulton se, situata e mbipopullimit në raport me kapacitetin fizik të institucionit, ka qenë në shifra nga 19% deri në 28% mbi kapacitetin e institucionit. Lidhur me situatën e mbipopullimit, drejtuesit e institucionit e konsideronin jo shumë problematike, pasi nga viti i ndërtimit të IEVP-së Fushë-Krujë, kapaciteti fizik i tij ka ndryshuar, duke e justifikuar këtë me zgjerimin e ambienteve të destinuara për banim dhe shtimin e shtretërve në dhomat e banimit. Ndërkohë që kapacitetet e IEVP-ve duhet të miratohen dhe të sigurojnë kushte të përshtatshme jetese dhe ambiente rekreative.

Avokati i Popullit konsaton se rritja e kapaciteteve akomoduese në institucion nuk është e justifikuar me krijimin e ambienteve të reja, pasi godinat e banimit në këtë IEVP për të burgosurit, janë të njëjta që prej kur ka filluar aktivitetin si institucion. Përshtatja e ambienteve dhe krijimi i dhomave të banimit brenda regjimit, shkakton tejkalimin e normës prej 4m² hapësirë jetike për person, e cila konsiderohet si shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit për person, si dhe trajtim degradues e jo njerëzor³. Shkelja e këtij standardi është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitave monitoruese në Shqipëri, i cili në përfundim të vizitës ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare se: *“Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.

Referuar urdhrin për kategorizimin e IEVP-së, të burgosurit ishin të ndarë sipas sektorëve në 2 godina banimi në regjimin e brendshëm. Nga informacioni, kompletimi me shtretër në godinën “A” ishte me 200 shtretër dhe godinën “B” me 262 shtretër, pra në total IEVP Fushë-Krujë ishte e plotësuar me 462 shtretër.

Sa më sipër, tregon se kapaciteti i miratuar prej 312 persona nuk konsiderohet si kapaciteti maksimal nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Për këtë Avokati I Popullit kërkon shpjegim të hollësishëm nga DPB-ja.

Situata e mbipopullimit ishte evidente në sektorin ku ishin të akomoduar të paraburgosurit. Në dhomat e përshikuara për 2 dhe 4 persona, ishin akomoduar 4 dhe 6 persona. Pavarësisht kësaj shtate, grupi i inspektimit nuk konstatoi asnjë të paraburgosur të flinte me dyshekë në tokë, por ishin të pajisur me krevat dhe materiale fjetje.

Për shkak të situatës së mbipopullimit, ishte evidente shkelja e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve dhe në standardet ndërkombëtare, ku përcaktohet se çdo qeli duhet të ofrojë minimalisht kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m², si norma jetike për person⁴.

Në këto kushte edhe MKPT vlerëson se, mbipopullimi ngelet një problem shqetësues për IEVP Fushë-Krujë, pasi rritja e numrit të shtretërve në dhomat e banimit nuk është kriter që përcakton kapacitetin fizik të institucionit, përkundrazi bie ndesh me normat dhe parametrat teknikë që përcaktojnë ndërtimin e dhomave të banimit, si dhe çënojnë rëndë kushtet e jetesës të të burgosurve.

Mbipopullimi ndikon edhe te organika e institucionit, pasi ajo është e miratuar për ti shërbyer kapacitetit zyrtar dhe jo 20% më shumë prej disa vitesh.

Struktura organike e institucionit ishte e miratuar me urdhër nr.43 datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj”. Referuar strukturës organike të miratuar, IEVP Fushë-Krujë kishte mungesa në 11 punonjës, nga të cilët 7 punonjës policie dhe 4 punonjës të stafit civil. Mungesat në stafin civil konsistojnë: 1(një) përgjegjës i sektorit juridik, 1(një) përgjegjës i sektorit shëndetësor dhe 2(dy) specialist në sektorin e çështjeve shoqërore.

Nga informacioni u evidentua se, në institucion ndodheshin 18 të burgosur të grupmoshës 18-21 vjeç, të cilët ishin të sistemuar në dhoma me të burgosurit e tjerë dhe jo në dhoma më vehte. Nga intervistimi i tyre, u evidentua se me këtë grupmoshë zhvillohej një program i veçantë trajtimi psiko-social nga specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore. Po ashtu edhe orari i ajrimit për këtë kategori kryhej sipas orarit të veprimeve të specifikuar për secilin sektorë.

Në IEVP Fushë-Krujë, krahas zbatimit të protokolleve shëndetësore për ruajtjen e shëndetit të të burgosurve, personeli i sektorit shëndetësor, trajtonte me prioritet disa kategori të veçanta si të sëmurët kronik, të sëmurët me diabet, të sëmurët me probleme të shëndetit mendor, si dhe të burgosurit e evidentuar si përdorues të lëndëve narkotike. Nga inspektimi, nuk rezultoi asnjë të burgosur i shtruar në spital në sektorin e infermierisë, që të vuante nga ndonjë sëmundje.

Nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i i mëparshëm, rezultoi se, vetëm një pjesë e tyre ishin realizuar. Konkretisht:

⁴ Neni 30, Rregullore e Përgjithshme e Burgjeve: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

1. Ambientet e veçimit dhe të observimit ishin të boshatisura, pasi godina do ti nënshtrohej një rikonstruksioni të plotë, në kuadër të një projekti të plotë për rikonstruksionin e godinave që ndodheshin në regjimin e brendshëm të institucionit, me financimin e buxhetit të shtetit.
2. Në ambientet e takimeve të të burgosurve, ishin shtuar edhe nga një kompjuter me qëllim komunikimin online të tyre me familjet, sipas numrit të përcaktuar në rregulloren e brendshme, për takimet fizike dhe takimin online për të burgosurit.
3. Në dhomat e banimit të të paraburgosurve, ku ishin akomoduar 4 dhe 6 persona, ishin siguruar disa orendi shtesë si stola, komodina apo rafte për mbajtjen e sendeve personale
4. Brenda regjimit të brendshëm të I EVP-së ishte hapur një klasë për zhvillimin e mësimin të arsimit 9-vjeçar, në bashkëpunim me zyrën arsimore në Krujë.
5. Të burgosurit e grupmohës 18-21 vjeç, zhvillonin programe individuale këshillimi dhe trajtimi psiko-social nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore, sipas një programi të miratuar nga DPB.
6. Ambientet e dhomave të banimit, si dhe ambientet e përbashkëta si dushet, klasat e edukimit, kuzhina dhe magazinat e ushqimeve të institucionit, ishin dezinfektuar rregullisht 3 herë në vit sipas shërbimit 3D (dezinfektimit, dezinfektimit, deratizimit), për eliminimin e brejtësve.
7. Shërbimi stomatologjik për të burgosurit kryhej rregullisht, me dhomë të veçantë e cila ishte e pajisur me poltron të ri dhe pajisje dentare, ku kryheshin ndërhyrjet në rastet e urgjencave, por jo mbushje të dhëmballëve apo ekstraksioneve.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet **nuk** kishin gjetur zbatim, për arsye të mungesës së fondeve buxhetore për investime, por dhe mungesa të tjera që lidhen me organet e tjera jashtë sistemit penitenciar apo dhe mungesave në stafin e institucionit, si më poshtë vijon:

1. Vijonte të ishte evidente situata e mbipopullimit, për shkak të numrit të lartë të masave të sigurisë lëshuar nga gjykatat kompetente, si dhe mungesës të një urdhëri të DPB-së, për përcaktimin e kapaciteteve akomoduese që duhet të ketë I EVP Fushë-Krujë, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara për këtë qëllim.
2. Kishte mungesë të mjekut të përgjithshëm (me kohë të plotë) dhe mjekut psikiatër në institucion, për kryerjen në kohë të vizitave mjekësore për të burgosurit, kryesisht të sëmurëve kronikë dhe me probleme të shëndetit mendor.
3. Situata e furnizimit me ujë e ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit nuk ishte përmirësuar, gjë e cila ndikonte në situatën e përkeqësuar të mbajtjes së higjienës personale të të burgosurve, papastërtinë e ambienteve të përbashkëta, si dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
4. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për rregullimin dhe vënien në përdorim të kaldajës qëndrore dhe sistemit ngrohje/ftohje për ambientet në regjimin e brendshëm, sipas kushteve klimaterike.
5. Nuk ishin marrë masa për përmirësimin e situatës të furnizimit me energji elektrike të ambienteve në regjimin e brendshëm, pasi nuk ishte kryer lidhja e linjës së brendshme të institucionit me linjën e jashtme të furnizimit 20 KË, si dhe për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik në dhomat e banimit dhe ambientet e dusheve.

6. Nuk ishin kryer investime për hidroizolim të tarracave të godinave të banimit në regjimin e brendshëm, pasi në disa dhoma banimit dhe ambientin e dusheve kishte ende lagështirë.
7. Në ambientin e kuzhinës nuk ishin marrë masa për heqjen nga përdorimi të enëve të vjetëruara të shpërndarjes së ushqimit të të burgosurve dhe zëvendësimin e tyre me enë të reja.
8. Biblotekat e institucionit, nuk ishin të pasuruar me libra të rinj dhe nuk kishte rritje të interesit të të burgosurve për frekuentimin dhe leximin e librave.

Trajtimi i të burgosurve

Vizita inspektuese në I EVP Fushë-Krujë, kishte për qëllim që nga informacioni i dhënë nga drejtori dhe stafi i institucionit, inspektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe intervistat me të burgosurit të mblidhte të dhëna, fakte, prova dhe dëshmi që kishin të bënin me trajtimin e të burgosurve, identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar në aktet normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Një aspekt tjetër, ishte dhe verifikimi i procedurave ligjore të ndjekura nga komisioni i disiplinës i institucionit, në rastin e marrjes së vendimit për dhënien e masave disiplinore të lehta dhe të rënda, në përputhje me shkeljen e kryer nga të burgosurit.

Vlen të theksojmë se, nga informacioni i stafit të institucionit, por dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të burgosurit, grupi i inspektimit nuk konstatoi asnjë rast torture, trajtimi degradues, diskriminues apo dhe keqtrajtimi nga punonjësit e policisë të institucionit ndaj të burgosurve.

Një nga problemet që përbënte shqetësimin kryesor për të burgosurit, ishte situata e mbipopullimit në dhomat e banimit (4-6 persona në një dhomë) dhe tejkalimi i normës së lejuar prej 4m² hapësirë jetike për person, të cilat konsiderohet shkelje e standardit të sipërfaqes së banimit që duhet të disponojë një person i burgosur⁵. Kjo situatë, cënon rëndë gjithashtu edhe standardin e jetesës të këtyre personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën trajtim jo dinjitoz dhe degradues të të burgosurve. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka evidentuar problematikën e mbipopullimit në këtë I EVP, që prej vitit 2019.

Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitës monitoruese që ka zhvilluar në Shqipëri në vitin 2018, në përfundim të vizitës në disa institucione, lidhur me situatën e mbipopullimit, në raportin drejtuar autoriteteve të qeverisë shqiptare⁶ ka rekomanduar që: *“Të dënuarit/paraburgosurit duhet të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta*

⁵ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe neni 30 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

⁶ <https://rm.coe.int/168097986c>

në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”.

Sikurse theksuam, situata e mbipopullimit reflektohej gjithashtu dhe në përkeqësimin e kushteve higjeno-sanitare në ambientet e banimit dhe ambientet e përbashkëta ku zhvillonin aktivitetin të burgosurit. Grupi i inspektimit, konstatoi mungesë të higjenës, papastërti, prezencë të mbeturinave në dhomat e banimit, në ambientin e kuzhinës dhe ambientet e dusheve. Në këto kushte, strukturat përgjegjëse në I EVP Fushë-Krujë duhet të kryejnë detyrat e tyre funksionale dhe të reagojnë në mënyrë të menjëhershme për ndryshimin e kësaj situatë, pasi mbajtja e higjenës të ambienteve dhe largimi i mbeturinave, nuk kërkojnë fonde buxhetore apo kryerjen e investimeve. Ndërkohë që, drejtuesit e këtij institucioni duhet të nxjerrin përgjegjësitë konkrete ndaj kujdo punonjësi që ka lejuar me ose pa qëllim lejimin e përkeqësimit të kushteve higjeno-sanitare në të gjitha ambientet e institucionit, si dhe në bashkëpunim stafit dhe të burgosurit të ndërmarrin veprime konkrete për ndryshimin e kësaj situatë.

Nga inspektimi u evidentua gjithashtu se, kushtet infrastrukturore të godinave të banimit në regjimin e brendshëm, paraqisnin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve apo dhe kushtet jashtë standardeve të tualeteve e dusheve.

Sipas informacionit të drejtorit të institucionit, konfirmuar edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në ditën e inspektimit, I EVP Fushë-Krujë do të nënshtrohet një rikonstruksioni total gjatë vitit 2022 të godinave në regjimin e brendshëm, gjë e cila do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e jetesës për të burgosurit. Projekti për këtë investim, do të zbatohet me financime të buxhetit të shtetit.

Problematike ishte gjëndja edhe në kuzhinën e këtij institucioni, pasi gjëndja e enëve që përdoren për gatim dhe për shpërndarjen e ushqimit nuk ishte e mirë, ishin shumë të vjetëruara dhe kishin nevojë të menjëhershme për tu zëvendësuar me të reja. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ngritur këtë shqetësim edhe në inspektimet e mëparshme.

Lidhur me këtë problematikë, të burgosurit paraqitën ankesa edhe për mungesën e larmishmërisë të menisë së gatimit dhe cilësinë e ulët të gatimit të ushqimit. Në këto kushte, ata deklarorin se nuk merrnin ushqimin e gatuar nga institucioni dhe gatuanin në dhoma ushqimet që dërgoheshin nga familjarët e tyre dhe nuk konsumonin ushqimin e gatuar nga institucioni.

Masat mbrojtëse

Grupi i monitorimit, në përputhje me metodologjinë e inspektimit në burgje, kontrolloi dokumentacionin dhe plotësimin e tij sipas rubrikave për secilin sektorë, në lidhje me gjëndjen shëndetësore të të burgosurve, vlerësimin e kushteve psiko-sociale në dosjet për secilin prej tyre, llojet e aktiviteteve kulturore e sportive që zhvilloheshin me të burgosurit,

programet e trajtimeve dhe këshillimeve psiko-sociale individuale dhe grupmosha të caktuara, me qëllim intensifikimin e masave për rehabilitimin dhe më tej ri-integrimin e tyre. Në përfundim, grupi i inspektimit administroi një kopje të plotë të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikatat e punës sipas sektorëve.

Grupi i inspektimit u informua në lidhje me procedurat e ndjekura për hyrjet dhe pritjen e të burgosurve në institucion, si dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes. Nga intervista e zhvilluar me drejtuesin e institucionit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit grupi i inspektimit konstatoi se, procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte dhe regjistrat e dosjet personale të të burgosurve ishin plotësuar sipas rubrikave.

Vëmendje e veçantë gjatë inspektimit iu kushtua mënyrës se si funksiononte sistemi i kërkesë/ankesave të të burgosurve brenda institucionit dhe për korrespondencat e tyre me institucionet e tjera. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve ishin të regjistruara në një regjistër të veçantë që administrohej nga sekretaria e institucionit, si dhe ishin të protokolluara⁷. Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin te punonjësi i sektorit psiko-social i ngarkuar për çdo sektorë. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe sipas procedurës i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor.

Në sektorët e regjimit të brendshëm ndodheshin kuti postare ku të burgosurit mund të depozitonin ankesat/kërkesat e tyre në lidhje me institucionet e tjera jashtë sistemit të burgjeve. Për periudhën janar-qershor 2022 në sekretarinë e institucionit ishin evidentuar në regjistër gjithsej 249 kërkesë/ankesa nga të burgosurit. Objekti i kërkesave sipas shënimeve në regjistër ishin të ndryshme, për komunikim online me familjarët e tyre, kërkesa për punësim, kërkesa për takim në dhomën e prindërimit, kërkesa për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj.

Ambientet e takimeve fizike me familjarët ishin të ndara më vete për personat e dënuar dhe për të paraburgosurit. Në secilin ambient kishte 3 dhoma për takime fizike me familjarët, 3 dhoma për takime me avokatët mbrojtës dhe prokurorët, 2 dhoma për takime speciale dhe 1 dhomë për prindërim në distancë. Nga inspektimi i ambientit të takimeve dhe intervistat me të burgosurit, takimet me familjarët zhvilloheshin 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online (në varësi të zgjedhjes të gjithsecilit prej tyre). Veç këtyre takimeve, të burgosurit familjarë kishin filluar të zhvillonin edhe takime në dhomat e prindërimit në distancë, si dhe takimet speciale në ambientet e dedikuara për këtë qëllim.

Ndërsa, numri i telefonatave të të burgosurve me familjarët ishte 8 herë në muaj, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Aparatet e telefonave me kartë,

⁷ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

ishin të instaluar në korridoret e secilit sektorë në regjimin e brendshëm. Aparatet ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të burgosurit, ata deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Por, të burgosurit kërkonin që të shtoheshin aparatet e telefonit në çdo sektorë, pasi nga dy kompani telefonike që operonin në sistemin e burgjeve, aktualisht është vetëm një kompani, gjë e cila ka sjellë si pasojë që rritjen fiktive të çmimit të blerjes së kartës, ndërkohë që koha e bisedës të jetë më e ulët. Rreth 50% e aparateve telefonik ishin të bllokuar dhe nuk funksiononin.

Grupi i inspektimit verifikoi nëse funksionon apo jo numri i kontaktit me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit. Nga kontrolli rezultoi se, të burgosurit **nuk** mund të komunikonin me institucionin tonë, pa tarifë shtesë sikurse përcaktohet në nenin 67 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit, pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrit të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur”*.

Pavarësisht këtij konstatimi, shqetësimi është i përsëritur dhe është ngritur edhe nga të burgosurit në IEVP-të e tjera, gjatë vizitave inspektuese që ka zhvilluar MKPT. Ndaj është e domosdoshme që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet që mbi bazën e një studimi të kryer për kapacitetet e nevojshme për këtë lloj shërbimi, të rishikojë menjëherë kontratat me subjektin që ofron shërbimin e telefonave me kartë në sistemin e burgjeve, të shtojë numrin e operatorëve privatë nëse e shikon të arsyeshme me qëllim ofrimin e një shërbimi më të mirë komunikimin e të burgosurve me familjarët e tyre, si dhe të rrisë efektivisht komunikimin me Avokatin e Popullit dhe çdo organizatë jo qeveritare që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, në lidhje me adresimin në kohë sa më të shpejtë të ankesave që mund të kenë për shkeljen e të drejtave të tyre të ligjshme.

Në IEVP Fushë-Krujë ndodheshin 18 të burgosur të moshës 18-21 vjeç, të cilët **nuk** ishin të sistemuar në dhoma më vete, por ishin të integruar në dhoma me të burgosurit e tjerë, për arsye të përshtatjeve dhe njohjeve që ata kishin. Nga punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore këta persona trajtoheshin me program trajtimi PIT (programe individuale trajtimi) të miratuar nga DPB. Ndërkohë, orari i ajrimit dhe i aktiviteteve zhvillohej njëherësh me të burgosurit e tjerë, sipas sektorëve ku këta persona ishin të akomoduar.

Nga verifikimi i organikës së punësimit, institucioni kishte të miratuar 28 të burgosur, kryesisht sanitarë, shpërndarës ushqimi, berber, lavanderi, mirëmbajtës, etj. Nga informacioni i stafit të institucioni dhe intervistat me të punësuarit rezultoi se, nga muaji Tetor i vitit 2021 kur u miratua VKM nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”* deri në muajin Maj të vitit 2022, ende **nuk** kanë përfunduar procedurat e miratimit dhe lidhjes së kontratës tip të punës midis institucionit dhe të burgosurit të punësuar. Për këtë shkak, të burgosurit e punësuar, për një periudhë 7 mujore, nuk përfitonin asnjë të drejtë, qoftë me ulje ditë dënimi dhe as nuk ishin trajtuar financiarisht

për shpërblimin e punës, sipas kësaj VKM. Sa më sipër, është shkelje e hapur e të drejtave të burgosurve të punësuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, vonesat në miratimin e kontratës “tip” për të punësuarit, është shkelje e të drejtës për të përfituar nga mundësitë që u jep ligji kësaj kategorie, por njëkohëshit përbën shkelje të organit shtetëror përgjegjës të ngarkuar me ligj, për moszbatimin në kohë të të gjitha të detyrimeve që rrjedhin prej tij. Ndaj kjo e drejtë ligjore nuk duhet mohuar nga DPB, por duhet të fillojë llogaritjen e efekteve financiare nga koha e miratimit të VKM-së së mësipërme.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Në I EVP Fushë-Krujë, kamerat monitoronin gjithë ambientet në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm përgjatë 24 orëve dhe pamjet filmike ruheshin në server për një periudhë 30 ditore.

Kushtet materiale

Kushtet materiale dhe infrastruktura e I EVP-së Fushë-Krujë, në përgjithësi i plotësojnë kushtet e nevojshme për jetesë të të burgosurve, zhvillimin normal të aktiviteteve me karakter kulturor dhe sportiv, ajrimin, si dhe garantojnë elementët e sigurisë fizike për ruajtjen e jetës dhe shëndetit të të burgosurve, që vuajnë dënimin në këtë institucion.

Por, pavarësisht se ky institucion ka filluar të funksionojë në vitin 2008, gjendja teknike e godinave në regjimin e brendshëm, në veçanti në disa dhoma banimi, në dhomat e veçimit e të observimit, dhomat e spitalit, tualetet dhe dushet e përbashkëta në çdo sektorë, ishin të amortizuara nga prezenca e lagështirës.

Sipas informacionit, lagështia në këto ambiente ishte për shkak të dëmtimit që kanë pësuar tarracat e godinave të banimit, të cilat në vite nuk janë izoluar dhe nuk është kryer asnjë investim për rikonstruksionin e tyre.

Në kushtet që ndodhen këto ambiente, prezenca e lagështirës në dhomat e banimit përveçse dëmton rëndë shëndetin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion, nga gjendja teknike godinat e banimit janë të amortizuara dhe nuk garantojnë sigurinë e jetës të të burgosurve, pasi brenda këtyre ambienteve ata kryejnë pothuajse gjithë aktivitetin e tyre ditor.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson hapat e ndërmarrë nga DPB-ja për hartimin e projektit dhe nxjerrjen e fondeve për rikonstruksionin e plotë të godinave në regjimin e brendshëm të kësaj I EVP, por është e domosdoshme të përshpejtohen procedurat për zbatimin e menjëhershëm të këtij projekti, pasi në gjendjen në të cilën ato ndodhen, nuk garantojnë kushtin kryesor të ruajtjes së shëndetit të të burgosurve dhe sigurinë e jetës së tyre.

Nga inspektimi u evidentua se, çdo dhomë banimi ishte e plotësuar me materiale fjetje si krevat, dyshekë, batanie, çarçafë e jastek dhe pavarësisht mbipopullimit, nuk rezultoi asnjë person që të flinte me dyshekë në tokë. Por, nga intervistat me të burgosurit u evidentua se, një pjesë e të burgosurve i siguronin materialet e fjetjes nga familjet e tyre, pasi materialet që furnizonte institucioni ishin jashtë përdorimit dhe të vjetëruara.

Një problematikë që u evidentua gjatë inspektimit, kishte të bënte me mungesën e orendive të nevojshme në dhomat e banimit si karrige për qëndrimin ulur dhe komodina për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve. Grupi i inspektimit konstatoi që sendet personale të të paraburgosurve mbaheshin e qeska në çanta të varuara në mure dhe të ekspozuara në ambientin e dhomave. Sipas informacionit, furnizimi me orenditë shtesë ishte i pamundur, kjo për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së hapësirave në dhomat e banimit, për lejimin e tyre.

Në dhomat e banimit ndodheshin tualetet që shërbenin për mbajtjen e higjenes dhe kryerjen e nevojave personale. Ato në përgjithësi ishin të kompletuara me nyje hidrosanitare dhe me rubineta që furnizoheshin me ujë të rrjedhshëm sipas grafikut dhe orarit të miratuar nga drejtori i institucionit. Në disa dhoma, dyert e tualeteve ishin të thyera dhe të dëmtuara dhe në vend të tyre të burgosurit kishin adoptuar mbylljen e tualetit me mjete rrethore, gjë e cila bashkë dhe me lagështirën, krijonte një erë të rëndë në ambientin e banimit.

Drita natyrale dhe niveli i ajrit në dhoma ishin të mjaftueshme, pasi dritaret ishin me përmasa të tilla që lejonin hyrjen e dritës dhe të ajrit natyral. Ambientet në regjimin e brendshëm kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik, i cili për shkak të mbingarkesës së linjës, herë pas here paraqiste probleme me furnizimin me energji dhe kishte difekte të shpeshta në sistemin elektrik. Përveç mbingarkesës së linjave, shqetësuese ishte dhe gjendja e amortizuar e instalimeve elektrike në ambientet e brendshme të godinave, ku dalloheshin qartë kabllot elektrik të ekspozuar në dysheme dhe varur në mure, duke përbërë rrezik për sigurinë e jetës së të burgosurve.

Një problematikë e konstatuar në vite në këtë institucion është edhe mungesa e funksionimit të sistemit qëndror për ngrohje/ftohje të ambienteve të brendshme. Kaldaja e këtij institucioni ekziston, por ajo nuk ka funksionuar që prej ndërtimit të institucionit. Në këto kushte, në stinën e dimrit dhe të verës, institucioni kishte lejuar përdorimin e pajisjeve elektrike për ngrohje/ftohje, të cilat edhe këto siguroheshin nga familjarët e të burgosurve.

Lidhur me këto problematika, I EVP Fushë-Krujë i ishte drejtuar me informacione mujore dhe shkresa zyrtare DPB (me projekte dhe preventiva për secilin nga këto investime), ku kërkohet ndërhyrja e menjëhershme me investime për përmirësimin kryesisht të rrjetit elektrik të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe riparimin e kaldajës qëndrore⁸.

⁸ Shkresë nr.466 prot., datë 11.03.2022 (e fundit).

Sa më sipër, është detyrë e strukturave përgjegjëse në IEVP dhe në DPB plotësimi i këtyre nevojave që kanë të burgosurit, pasi ato përbëjnë kushtet bazë për jetesë normale dhe strehim adekuat, sipas standardeve që përcaktohen aktet ligjore dhe n/ligjore për këtë qëllim. Rregullorja Evropiane e Burgjeve përcakton gjithashtu se: *“Strehimi që u ofrohet të burgosurve dhe në veçanti fjetja respektojnë dinjitetin njerëzor, dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privacinë si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës dhe veçanërisht hapsirës së dyshemesë, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*⁹.

Një problematikë tjetër që u evidentua nga grupi i inspektimit, ishte mungesa e furnizimit me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Aktualisht, furnizimi me ujë i ambienteve të brendshme të institucionit kryhej me orar të reduktuar, tre herë në ditë nga 1h30 min. Por, në kushtet e mbipopullimit koha e furnizimit me ujë ishte tepër e pamjaftueshme dhe nuk përballonte mbajtjen pastër të ambienteve të banimit dhe njëkohësisht larjen e trupit për të burgosurit. Në këto kushte, të burgosurit kërkonin që të kishin furnizim pandërprerje me ujë të rrjedhshëm gjatë gjithë ditës, ose minimalisht të zgjatej orari i furnizimit me ujë.

Ambientet e dusheve ishin të përbashkëta për secilin sektorë. Ato kishin numër të vogël të posteve të dusheve dhe nuk i përgjegjej kërkesave në rritje të të burgosurve dhe mbipopullimit të sektorëve, për larjen e trupit sipas nevojave të tyre. Ngrohja e ujit të dusheve kryhej me bolier me ngrohje elektrike, të cilët ishin vendosur të rinj, por kapaciteti i tyre nuk i përballonte fluksin e kërkesave për shkak të mbipopullimit. Për këtë arsye, të burgosurit ishin detyruar që të ngrohnin ujin me rezistenca elektrike në dhomat e banimit, duke përbërë rrezik për jetën e tyre dhe njëkohësisht shkaktonin mbingarkesë në rrjetin e brendshëm të furnizimit me energji elektrike.

Furnizimi i të burgosurve me produkte të higjienës si detergjente, qese plehrash, shampo, e artikuj të tjerë, kryhej sipas normativave çdo muaj nga sektori i logjistikës të institucionit. Por, të burgosurit në intervistat e tyre deklarorin se, këto normativa janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat që kanë të burgosurit për mbajtjen e higjienës, ndaj ata detyroheshin të blinin këto materiale në njësinë tregtare ose i siguronin nga familjarët e tyre.

Në lidhje me kushtet që institucioni duhet të sigurojë ndaj të burgosurve, sjellim në vëmendjen tuaj Rregullat Evropiane të Burgjeve, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Çdo të burgosuri duhet t’i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjienës së përgjithshme”*¹⁰. Ndërkohë, Rregullat Minimale të Trajtimit të të

⁹ Rregulla 18.1 e Rregullave Evropiane të Burgjeve.

¹⁰ Rregulla 19 e Rregullave Evropiane të Burgjeve

Burgosurve (ERM, Mandela Rules), rregulli 18¹¹, të pranuarë tashmë nga çdo shtet si një standard që duhet garantojnë institucionet për të burgosurit në burgje, përcaktojnë qartë se: *“Të burgosurve t’u kërkohet të mbajnë pastër higjenën e tyre personale dhe për këtë qëllim ata duhet të pajisen me ujë dhe artikuj tualeti që janë të nevojshme për shëndetin dhe pastërtinë”*.

Në ambientet e banimit dhe ambientet e përbashkëta, nuk vihej re prezencë e insekteve dhe brejtësve, që tregonte se institucioni kishte marra masa për dezinfektimin e tyre. Por, ambientet e brendshme dhe kuzhina, për shkak edhe të lagështirës, kishin nevojë për lysterje dhe dizifektime të shpeshta, për larguar ndotjen dhe ajrin e rënduar të shkaktuar prej saj.

Lavanderia e institucionit ishte në gjendje funksionale, e pajisur me lavatriçe për larje dhe tharje të materialeve të fjetjes si batanie dhe çarçafë. Ndërsa rrobat personale, vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të burgosurit brenda ambientit të dhomave.

Grupi i inspektimit gjatë vizitës kontrollloi edhe ambientin e kuzhinës dhe cilësinë e gatimit të ushqimit, sipas normativave dhe menisë ditore të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Kuzhina e institucionit përbëhej nga ambienti i gatimit dhe ambientet e tjera ndihmëse për mbajtjen e pajisjeve frigoriferike dhe të furnizimit me produkteve ushqimore, të cilat ishin me hapsirë të bollshme. Stafi i kuzhinës përbëhej nga 4 guzhiner dhe 7 nd/guzhiner të punësuar nga institucioni, të pajisur të gjithë me librezë shëndetësore.

Menuja ditore dhe normativat e ushqimit ishin të afishuara në një stendë, ndërsa kampionët e ushqimit ruheshin sipas vakteve ushqimore në kushte frigoriferike. Gatimi i ushqimit kryhej i ndarë më vete për të burgosurit, për të sëmurët me diabet dhe për të burgosurit e punësuar. Sistemi i sobave të gatimit dhe ai i aspirimit, ishin funksional. Produktet ushqimore dhe ato të mishit ruheshin në kushte frigoriferike, të ndara në frigoriferë më vete. Shpërndarja e ushqimit nga kuzhina për në sektorë kryhej me enë të mëdha të vendosura në karrocë, ndërsa brenda godinave të banimit ato transportoheshin me krahë nga stafi i të punësuarve të burgosur, për secilin sektorë.

Grupi i inspektimit mori ankësë nga të burgosurit për kuotën e ulët ditore të ushqimit, pasi sasia e ushqimit ishte e pamjaftueshme. Kjo problematikë është evidentuar dhe rekomanduar nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite, por sikurse konstatohet, kuotat e ushqimit kanë mbetur të pandrysheshme që prej vitit 2006.

U evidentua se, godinat e banimit nuk kishin ashensorë për transportin e ushqimit nga njëri sektorë në tjetrin. Enët e kuzhinës që shërbenin për ndarjen e ushqimit, ishin të vjetëruara dhe kishin nevojë për zëvendësimin e tyre me pajisje të reja. Ambienti i kuzhinës në përgjithësi nuk ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjeno-sanitare. Në kohën e inspektimit, brenda në kuzhinë dhe në pjesën e jashtëme të saj u gjetën grumbull me

¹¹ Rregulla 12 Rregullave Minimale të Trajtitimit të të Burgosurve (ERM, Mandela Rules)
https://static.un.org/en/events/mandeladay/mandela_rules.shtml

mbeturina, të cilat kishin disa ditë pa u hequr nga personeli i kuzhinës dhe mbanin një erë të rëndë.

Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të plotësuar sipas rubrikave, të sekretuar dhe të protokolluar.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktivitetet ditore në këtë institucion zbatoheshin sipas orarit të veprimeve ditore të miratuar nga titullari i institucionit. Përsa i takon aktiviteteve me karakter kulturor dhe atyre sportive, ato ishin të programuara nga sektori i çështjeve shoqërore për çdo muaj dhe zhvilloheshin në bashkëpunim me punonjësit e sigurisë të institucionit.

Sektori i çështjeve shoqërore kishte në organikë 7 punonjës, nga të cilët 1(një) përgjegjës sektori dhe 6(gjashtë) specialist me profesion psikolog dhe punonjës të punës sociale.

Nga inspektimi u evidentua se institucioni kishte nga një bibliotekë më vehte për sektorin e të dënuarve dhe për sektorin e të paraburgosurve. Biblotekat pothuajse nuk ishin funksionale, pasi ato kishin numër të kufizuar me libra dhe hapësira të vogla, duke mos i përmbushur kërkesat për lexim të të burgosurve. Të burgosurit pasi regjistroheshin në një regjistër nga punonjësi i bibliotekës, u hapej kartela personale dhe më pas mund të tërhiqnin e dorëzonin librat sipas kërkesave të tyre.

E drejta e besimit dhe ushtrimit të riteve fetare, respektohej gjithashtu në këtë institucion. Aktivitetet fetare zhvilloheshin me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të komunitetit mysliman shqiptar në Krujë dhe nga shoqata kristiane e të burgosurve shqiptar. Ato zhvilloheshin në mjedise të veçanta që ndodheshin në regjimin e brendshëm, çdo javë sipas programit të miratuar nga drejtori i institucionit.

Në lidhje me ndjekjen e arsimit të detyrueshëm 9-vjeçar, institucioni në bashkëpunim me ZAV Krujë dhe kërkesave të të burgosurve, kishte hapur një klasë për zhvillimin e mësimin, e cila frekuentohej nga 15 të burgosur çdo ditë. Gjithashtu, gjatë inspektimit u evidentua se, institucioni në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Durrës, kishte hapur për të burgosurit e interesuar, disa kurse profesionale si për hidraulik, elektrikist dhe mësimin e gjuhës italiane, në të cilat merrnin pjesë 30 të burgosur.

Nga verifikimi i dokumentacionit të sektorit të çështjeve shoqërore, u evidentua se aktivitetet zhvilloheshin mbi bazën e programeve mujore, ndërsa në rastin e festave kombëtare, kryesisht festave fetare, ato ishin të organizuara me program të veçantë nga sektori i çështjeve shoqërore.

Dosjet personale të të burgosurve ishin të plotësuar rregullisht sipas rubrikave, me përmbledhje nga takimet më vehte me të dënuarit dhe të paraburgosurit, programet

individuale të trajtimit në të cilat ata kishin marrë pjesë, vlerësimet sipas tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, për llojin e asistencës së ofruar psikologjike, sociale apo mjekësore. Në dosjet psiko-sociale ishin të evidentuara edhe niveli i rrishtit referuar gjendjes psiko-emocionale që paraqiste çdo i burgosur, si dhe kohëzgjatja e trajtimit në varësi të qëndrueshmërisë së mendimeve dhe sjelljeve që ata reflektonin gjatë kohës të qëndrimit në këtë institucion.

Tërësia e aktiviteteve të zhvilluara dhe e trajtimeve psiko-sociale individuale dhe në grup me të burgosurit në këtë institucion, kishin si objektivi rehabilitimin, këshillimin dhe mbështetjen psikologjike të tyre, me qëllimin final ri-integrimit në shoqëri të kësaj kategorie pas përfundimit të periudhës së vuajtjes së dënimit.

Gjithsesi, ky komponent rezulton të ketë mangësi në të tërë sistemin penitenciar, e mbetet shumë për të bërë me qëllim plotësimin e tij, riintegrimin dhe rehabilitimin e të burgosurve.

Shërbimi shëndetësor

IEVP Fushë-Krujë, kishte në organikën e sektorit shëndetësor 10 punonjës, nga të cilët 2 mjek (i përgjithshëm dhe psikiatër), 1 farmacist, 1 stomatolog dhe 6 infermierë. Aktualisht kishte mungesë të një mjeku, i cili kryen njëkohësisht dhe detyrën e shefit të sektorit shëndetësor.

Grupi i inspektimit, nisur nga informacioni i drejtuesve të institucionit dhe nga intervistat me të burgosurit, konstatoi se shërbimet shëndetësore ndaj të burgosurve nuk ishin ndërprerë në asnjë moment.

Në regjimin e brendshëm të IEVP-së, ndodhej ambienti i infermierisë që përbëhej nga dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma e urgjencës ku qëndronin stafi i infermierëve. Këto ambiente ishin të kompletuara me orëditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, raftë për mbajtjen e medikamenteve, kartelave mjekësore individuale për çdo të burgosur dhe regjistrat mjekësorë.

Dhoma e stomatologut ishte funksionale dhe e pajisur me karrige, sterilizues, si dhe njësinë dentare, e cila përballonte çdo kërkesë të të të burgosurve për vizitë apo kontroll mjekësor. Në rastet e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe mbushjeve të dhëmbëve, ato nuk mund të kryeshin nga stomatologu i institucionit, por menjëherë pas kërkesës së të burgosurit, lëshohej rekomandimi i mjekut të institucionit dhe miratohej nga drejtuesi i institucionit, i cili më tej burgosuri shoqërohej për në klinikat private në qytetin e Krujës dhe shpenzimet mbuloheshin nga vetë i burgosuri ose familjarët e tij.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e infermierisë të institucionit nuk ndodhej asnjë i burgosur i sëmurë apo i shtruar me rekomandimin e mjekut, ndërsa gjendja shëndetësore e të burgosurve, paraqitej si me poshtë vijon:

- Të sëmurë kronik 42 të burgosur
- Të sëmurë me diabet 5 të burgosur
- Të sëmurë me problem të shëndetit mendor 12 të burgosur
- Përdorues të lëndëve narkotike, të cilët mjekoheshin me “methadone” 18 të burgosur.

Shërbimi shëndetësor për të burgosurit dhe të sëmurët kronikë, ofrohej nga personeli shëndetësor i institucionit, por në rastet e urgjencave të sëmurët shoqëroheshin për mjekim më të specializuar edhe në Spitalin e qytetit të Krujës. Shoqërimi i të sëmurëve për në spital, kryhej nga autoambulanca e institucionit, e cila ishte në gjendje të mirë teknike.

Në kushtet e mungesës të mjekut me detyrë edhe përgjegjës i sektorit shëndetësor, personeli ndihmës i infermierëve jepnin terapinë e të sëmurëve kronikë dhe atyre akutë, ndiqnin procedurën sipas protokollit shëndetësor dhe masat e sigurisë në burgje, duke qënë prezent në momentin e dhënies së ilaçeve dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Ndërsa të burgosurit me probleme të shëndetit mendor mbaheshin nën kontroll nga mjekët psikiatër që vinin sipas grafikut nga Spitali i Burgjeve në Tiranë. Personeli i infermierëve të institucionit, u jepte terapinë këtyre shtetasve sipas rekomandimeve të lëna nga mjekët psikiatër, duke qënë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mbikqyrnin me rigorozitet administrimin e tyre.

Në intervistat që zhvilloi grupi i inspektimit me të burgosurit, u evidentua se, ata kishin ankesa në lidhje me vonesat në kohë për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku institucionit, si dhe dërgimin e tyre për vizita mjekësore te mjekët specialist pranë Spitalit Krujë apo edhe për në Spitalin e Burgjeve në Tiranë. Ankesa u paraqitën edhe ndaj shërbimit stomatologjik të institucionit, për zvarritje të kërkesave të të burgosurve që kishin kërkuar kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe ekstraksioneve, pranë klinikave private.

Mungesa e mjekut në institucion, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje në shërbim mjekësor nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur. Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, mungesa e mjekut të institucionit me kohë të plotë përbën një problem shqetësues dhe të përsëritur, i cili duhet të marrë një zgjidhje përfundimtare nga DPB, pasi të burgosurve po ju mohohet e drejta për marrjen e shërbimit shëndetësor në kohë të shpejtë, si dhe paraqitjen e tyre pranë mjekëve specialistë sa herë që ata e shikojnë të nevojshme.

Ky vlerësim është i njëjtë me qëndrimet e mbajtura nga KPT(CPT)¹², në lidhje me përmirësimin e cilësisë të këtij shërbimi ndaj të burgosurve, për t’ju përgjigjur në kohë kërkesave të tyre, duke rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit*

¹² Komiteti për Parandalimin e Torturës

të burgosjes së tyre”, dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.

Gjithashtu, kjo përbën shkelje edhe të standardit të përcaktuar në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹³.

Ambientet e infermierisë si dhoma e mjekut, e stomatologut dhe farmacia ishin të lyera dhe në kushte të mira higjieno-sanitare.

Nga kqyrja e dokumentacionit të sektorit shëndetësor, në dhomën e mjekut dhe dhomën e urgjencave ndodheshin kartelat klinike të të burgosurve, regjistri i vizitave mjekësore, regjistri i kufizimeve fizike, regjistri i shërbimit 24 orësh të infermierëve, si dhe regjistri i shpërndarjes të medikamenteve mjekësore për të sëmurët kronikë. Këto dokumente ruheshin në rafte të veçantë, ishin të sekretuar dhe ishin të plotësuar sipas protokolleve shëndetësore.

Nga kqyrja e regjistrit për rastet e dëmtimeve fizike të të burgosurve apo përdorimit të dhunës, nuk u konstatua asnjë ngjarje e evidentuar apo e referuar nga personeli shëndetësor i institucionit ndaj tyre.

Theksojmë se, institucioni ishte i furnizuar me sasinë e nevojshme të medikamenteve të urgjencës dhe për të sëmurët kronikë, të cilat shpërndaheshin nga stafi shëndetësor i infermierëve, sipas rekomandimit të mjekëve specialist. Gjithashtu, të burgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, e cila e shoqëronte të burgosurin gjatë transferimeve nga njëra I EVP në tjetrën.

Skema e rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët kronikë, funksiononte sipas kontratës tre palëshe të lidhur mes FDSKSH-së, depos farmaceutike dhe institucionit, e cila i referohej historikut të sëmundjeve për çdo të dënuar dhe të burgosur, si dhe kartelave shëndetësore të të burgosurve të plotësuar nga mjeku i institucionit në. Njëkohësisht, furnizimi me ilaçe i institucionit kryhej periodikisht nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nëpërmjet blerjeve të drejtëpërdrejtë me fondet e akorduara në buxhetin e institucionit.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”,

¹³ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e menjëhershme, për pagimin e të burgosurve të punësuar dhe për lidhjen e kontratave të punës midis institucionit dhe të burgosurve të punësuar, sipas kritereve të përcaktuara në VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”.
2. Të përshpejtohen procedurat për zbatimin e menjëhershëm të projektit për rikonstruksionin e plotë të godinave në regjimin e brendshëm, pasi në gjendjen në të cilën ndodhen, nuk garantojnë ruajtjen e shëndetit të të burgosurve dhe sigurinë e jetës së tyre.
3. Të merren masa të menjëhershme për afishimin e numrave të telefonit të Avokatit të Popullit dhe organizatave jo qeveritare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, në lidhje me adresimin në kohë sa më të shpejtë të ankesave, për shkeljen e të drejtave të tyre të ligjshme.
4. Të merren masat e nevojshme për eliminimin e mbipopullimit në I EVP Fushë Krujë, pasi cënon rëndë kushtet e jetesës të të burgosurve dhe përbën trajtim jo dinjitoz e degradues të tyre.
5. Të merren masa organizative nga DPB për përcaktimin e kapacitetit fizik të I EVP Fushë-Krujë dhe I EVP-ve të tjera, duke marrë në konsideratë standartin e përcaktuar në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare.
6. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e vendit vakant të mjekut me kohë të plotë dhe mjekut psikiatër në institucion, për të garantuar një sistem efektiv të shërbimit shëndetësor të të burgosurve, kryesisht për të sëmurët kronikë dhe ata me probleme të shëndetit mendor.
7. Të merren masa të nevojshme nga institucioni që në bashkëpunim me UK Krujë, të përmirësojnë situatën e furnizimit pa ndërprerje me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm ose të gjejnë zgjidhje alternative për furnizimin me ujë, me qëllim mbajtjen

e higjenës personale të të burgosurve, si dhe pastërtinë në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta.

8. Të marren masa e nevojshme, për vënien në funksion të kaldajës qendrore dhe përmirësimin e sistemit qendror për ngrohje/ftohje të ambienteve në regjimin e brendshëm.
9. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës të mungesës së energjisë elektrike dhe sigurimin e fondeve për riparimin e rrjetit të brendshëm elektrik në dhomat e banimit dhe ambientet e dusheve.
10. Të merren masa të menjëhershme për zëvendësimin e enëve të vjetëruara të kuzhinës për gatim dhe atyre që shpërbejnë për shpërndarjen e ushqimit të të burgosurve, me pajisje kuzhine të reja.
11. Të merren masat e nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kryerjen e një studimi mbi kapacitetet e nevojshme për ofrim më cilësor të shërbimit telefonik të të burgosurve me familjarët e tyre. Të rishikohet kontratat me subjektin që ofron aktualisht shërbimin e telefonave në sistemin e burgjeve, si dhe shtimin e numrit të operatorëve privatë.
12. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin me pajisje hotelerie të dhomave të banimit si karrige për qëndrimin ulur dhe komodina për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve.
13. Të merren masa të menjëhershme për furnizimin e bibliotekave të institucionit me libra të rinj dhe vënie në funksionim të plotë të saj, me qëllim rritjen e interesit të të burgosurve për leximin.
14. Të merren masa për të kërkuar ndryshimin e kuotës ushqimore, pas rritjes së numrit të produkteve bazë dhe përmirësimin të larmishmërisë së tyre.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI